



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rr. "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel 04 22268141; 22268142

Nr. 95/5 Prot.

Tiranë, më 17.07.2017

V E N D I M

Nr.164, datë 17/07/2017

"Mbi përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 155, datë 12.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë"

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin Nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në lidhje me verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 155, datë 12.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë",

VËREJ SE:

Me Vendimin Nr.139, datë 30.12.2015, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjit në procesin e administrimit të shërbimit civil, në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka vendosur fillimin e procesit të mbikëqyrjes së përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe institucionet e varësisë që janë pjesë e shërbimit civil. Bazuar në këtë vendim ka vijuar mbikëqyrja edhe në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë. Ky proces është përmblyllur me Vendimin Nr. 155, datë 12.12.2016, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë", të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në të cilin është vendosur:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.

2. *Për të rregulluar situatën në lidhje me pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit të qarkut me qëllim sqarimin e rolit të tij në skemën e administrimit të shërbimit civil, njësia përgjegjëse (DAP), duhet të përcaktojë kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet ky pozicion, ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Ky proces duhet të gjejë pasqyrim edhe në përshkrimin e punës për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit.*
3. *Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si organizma që menaxhojnë burimet njerëzore të institucionit, të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, lidhjeve pjesë e këtij vendimi dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.*

Institucioni i mbikëqyrur t'i kërkojë Departamentit të Administratës Publike, që të japë zyrtarisht konfirmimin e tij, lidhur me përshkrimet e punës, nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), përshkrimet e punës t'i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të vijuar procesin me nënshkrimin e tyre në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18, shkronja “c”, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

4. *Të kërkoj nga njësia përgjegjëse (DAP), për të rregulluar situatën e paligjshmërisë lidhur me emërimin e punonjësit ***** në pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, të kryejë veprimet e mëposhtme:*
 - *Revokimin e aktit nr. 2926/22, datë 14.10.2014, “Akti i deklaramit të statusit të punësimit”, të Departamentit të Administratës Publike.*
 - *Përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësin ***** , pasi emërimi është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.*

- *Pozicioni i tij i punës, duhet të shpallet pozicion i lirë dhe njësia përgjegjëse duhet të plotësojë këtë pozicion nëpërmjet procedurës së konkurrimit, në përputhje me kërkesat e ligjit për shërbimin civil.*

5. *Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, për punonjësit *****, ***** dhe *****, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit, si dhe akteve të nxjerra në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, pasi pozicionet e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk janë pjesë e shërbimit civil, por janë funksione të deleguara.*

Për ndreqjen e këtyre parregullsive, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të veprojë si më poshtë:

- *Të anulojë aktin nr. 2926/23, datë 14.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, si dhe aktin nr. 1279/16, datë 12.04.2016, “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, të nxjerra për punonjësin *****, me detyrë “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile”, në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë.*
 - *Të anulojë aktin nr. 2926/13, datë 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, si dhe aktin nr. 1279/15, datë 12.04.2016, “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, për punonjësen *****, me detyrë “Specialist i zyrës së gjendjes civile”, Nënprefekti i Rrethit Mirditë, në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë.*
 - *Të anulojë aktin nr. 2926/14, datë 14.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, për punonjësin *****, me detyrë “Specialist i zyrës së gjendjes civile”, Nënprefekti i Rrethit Kurbin, në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë, i cili aktualisht është larguar nga detyra.*
6. *Të kërkoj nga njësia përgjegjëse (DAP) të revokojë aktin e emërimit nr. 53, datë 30.06.2014, për punonjësen *****, në pozicionin e punës “Përgjegjës në Sektorin Juridik dhe Funksioneve të Deleguara”, si akt absolutisht i pavlefshëm, pasi është kryer në kundërshtim me procedurat ligjore dhe të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjëse.*

Pozicioni i punës duhet të shpallet i lirë dhe njësia përgjegjëse duhet të plotësojë këtë pozicion, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, në përputhje me kërkesat e ligjit për shërbimin civil.

7. *Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, duhet të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore për masat e marra ndaj nëpunësve *****, ***** dhe *****, duke u*

kujdesur që në zbatim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të mësipërme, për shkak të mosrespektimit të procedurës së përcaktuar në dispozitat ligjore të mësipërme.

Për ndreqjen e parregullsive të mësipërme, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë duhet të kryejë veprimet si më poshtë:

- *Anulimin e urdhrimit nr. 818, datë 16.06.2016, të Prefektit të Qarkut Lezhë, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për nëpunësin Ndoc Zogu.*
- *Anulimin e urdhrimit nr. 20, datë 24.02.2016, të Prefektit të Qarkut Lezhë, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për nëpunësin Ilir Ndoka.*
- *Anulimin e urdhrimit nr. 18, datë 24.02.2016, të Prefektit të Qarkut Lezhë, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, për nëpunësin Nderim Muçaj.*
- *Fshirjen e masave disiplinore për nëpunësit *****, ***** dhe ***** nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës.*

8. *Të kërkojë nga Njësia Përgjegjëse që për rregullimin e ligjshmërisë të veprojë në këtë mënyrë:*

- *Të revokojë aktin nr. 32, dt. 20.04.2016, “Për lirim nga Shërbimi Civil”, për nëpunësin *****, “Inspektor në Sektorin e Auditimit të Brendshëm”*
- *Të revokojë aktin nr. 31, dt. 20.04.2016, “Për lirim nga Shërbimi Civil”, për nëpunësin *****, “Inspektor në Sektorin e Auditimit të Brendshëm”*
- *Të revokojë aktin nr. 28, dt. 20.04.2016, “Për lirim nga Shërbimi Civil”, për nëpunësin *****, “Specialist (për emergjencat civile) nënprefekti i rrethit Kurbini”*
- *Të revokojë aktin nr. 30, dt. 20.04.2016, “Për lirim nga Shërbimi Civil”, për nëpunësin *****, “Specialist (i shërbimeve) nënprefekti i rrethit Mirditë”*
- *Të revokojë aktin nr. 29, dt. 20.04.2016, “Për lirim nga Shërbimi Civil”, për nëpunësin *****, “Specialist (për emergjencat civile) nënprefekti i rrethit Mirditë”*

Pas kësaj, këto raste duhet t’i dërgohen Komisionit të Ristrukturimit për të rishikuar mundësinë e sistemimit të tyre në vendet e lira ekzistuese. Në rast të mosplotësimit të kriterëve të argumentohet vendimi i lirit, duke përcaktuar qartë arsyet konkrete të këtij veprimi, si dhe të përcaktohen të drejtat e nëpunësve për dëmshpërblimin dhe për konkurrimin për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, brenda 2 viteve.

9. *Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 60 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 155, datë 12.12.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë, prej datës 21.07.2016, që është momenti i verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes e në vazhdim, me Vendimin Nr. 19, datë 09.02.2017, *“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit Nr. 155, datë 12.12.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 21.07.2016 e në vazhdim”*, ka vendosur fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit Nr. 155, datë 12.12.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.

Për këtë qëllim u ngrit grupi i punës, me përbërje Altin Shumeli, Drejtor i Mbikëqyrjes, Zamira Mujali, Inspektore në Drejtorinë e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ dhe Ledina Zhupa, Inspektore në Drejtorinë e Mbikëqyrjes, të cilët në datën 10.03.2017, u paraqitën pranë institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë.

Verifikimi u realizua nëpërmjet vizitës në institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë, dhe subjekti u njoftua për fillimin e procesit me shkresën nr. 95/2 prot., datë 09.02.2017, *“Njoftim për fillimin e verifikimit”*.

Grupi i punës, gjatë vizitës në subjekt komunikoi me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe u vu në dijeni të faktit se njësia përgjegjëse e këtij institucioni nuk kishte marrë masat e duhura për të zbatuar detyrat e lëna në Vendimin paralajmërues Nr. 155, datë 12.12.2016, të Komisionerit. Për arsye objektive (*konflikti me Sekretarin e Përgjithshëm të institucionit, i cili nuk e kishte përcjellë Vendimin e Komisionerit tek Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse*), nuk u morën masat e duhura në kohë për zbatimin e rekomandimeve të lëna në vendimin paralajmërues. Ky fakt vërtetohet dhe me procesverbalin e mbajtur midis Përgjegjësit të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse të Prefektit të Qarkut Lezhë dhe grupit të verifikimit, datë 10.03.2017.

Gjendur para këtij fakti, nga Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, u kërkua të shtyhej afati i zbatimit të këtij vendimi.

Pas shqyrtimit të kësaj kërkesë, institucionit të mbikëqyrur iu la afati i kërkuar 15 ditore për zbatimin e Vendimit paralajmërues Nr. 155, datë 12.12.2016.

Me kalimin e afatit, njësia e burimeve njerëzore, me shkresën nr. 486/11 prot., dt. 27.03.2017, *“Njoftim mbi zbatimin e detyrave të përcaktuara në Vendimin Nr. 155, datë 12.12.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”*, ka dërguar dokumentacionin që materializon zbatimin e detyrave të lëna në vendimin paralajmërues.

Pasi u administrua dhe trajtua dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezultoi se:

- Në lidhje me rekomandimin për sqarimin e rolit të Sekretarit të Përgjithshëm në institucionin e prefektit të qarkut në skemën e administrimit të shërbimit civil, në

përfundim të verifikimit në subjekt rezultoi se Departamenti i Administratës Publike nuk është shprehur ende në lidhje me kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet ky pozicion ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të Vendimit Nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*, i ndryshuar, sikundër ishte lënë detyrë në pikën 2 të dispozitivit të vendimit të Komisionerit.

- Në zbatim të pikës 3 të vendimit, Njësia e Burimeve Njerëzore të institucionit ka hartuar përshkrimet e punës për pozicionet e shërbimit civil. Me shkresën nr. 398 prot., datë 24.03.2017, *“Dërgohen përshkrimet e reja të punës për pozicionet e shërbimit civil”*, i është kërkuar Departamentit të Administratës Publike që të konfirmojë nëse përshkrimet e punës janë hartuar në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç përcaktohet në pikën 19, të Vendimit Nr.142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”*.

Në momentin e verifikimit, nga ana e Departamentit të Administratës Publike nuk është kthyer përgjigje në lidhje me shkresën e sipërcituar.

- Në lidhje me rekomandimin e bërë në pikën 4 të vendimit paralajmërues të Komisionerit, për revokimin e aktit të deklarimit të statusit dhe përfundimin e marrëdhënies së punësimit për punonjësin Altin Jaku, me detyrë *“Sekretar i Përgjithshëm”*, rezulton se me Vendimin Nr. 2, datë 24.03.2017, të Komisionit të Disiplinës, për këtë punonjës është marrë masa disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*, për shkak të mungesës së pajustificuar dhe të vijueshme për më shumë se 7 ditë pune. Me shkresën Nr. 415 Prot., datë 28.03.2017, ky vendim i është përcjellë Departamentit të Administratës Publike.

Pavarësisht faktit që rekomandimi i Komisionerit nuk është zbatuar në mënyrë korrekte, me largimin nga shërbimi civil të këtij punonjësi, situata e ligjshmërisë është vendosur.

- Në zbatim të pikës 5 të vendimit, me shkresën nr. 368 prot., datë 13.03.2017, *“Kërkesë për anulim të akteve të deklarimit të statusit të nëpunësit civil për punonjësit e zyrave të gjendjes civile”*, Prefekti i Qarkut Lezhë, i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike, anulimin e tre akteve të deklarimit të statusit të punësimit për punonjësit e gjendjes civile, si akte absolutisht të pavlefshme, të nxjerra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, pasi pozicionet e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën, nuk janë pjesë e shërbimit civil, por janë funksione të deleguara. Aktualisht, pritet reagimi i njësisë përgjegjëse, (DAP) për zbatimin e kësaj pike të vendimit.
- Në zbatim të pikës 6 të vendimit, Prefekti i Qarkut Lezhë, me Vendimin Nr. 60, datë 01.09.2016, *“Për lirim nga detyra”*, ka revokuar aktin e emërimit Nr. 53, datë 30.06.2014, për punonjësen ***** në pozicionin e punës *“Përgjegjës në Sektorin Juridik dhe Funksioneve të Deleguara”*, si akt absolutisht i pavlefshëm (pasi është kryer

në kundërshtim me procedurat ligjore) dhe ka vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjëse.

Aktualisht, Departamenti i Administratës Publike e ka shpallur këtë pozicion pune të lirë.

- Në zbatim të pikës 7 të vendimit, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve të dala gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore, për punonjësit *****; ***** dhe *****; dhe ka kryer veprimet si më poshtë:

Me Urdhrin Nr. 8, datë 13.03.2017, “Për anulimin e masës disiplinore”, ka anuluar Urdhrin Nr. 818, datë 16.06.2016, “Për dhënien e masë disiplinore ‘Vërejtje’”, ndaj nëpunësit *****.

Me Urdhrin Nr. 10, datë 13.03.2017, “Për anulimin e masës disiplinore”, ka anuluar Urdhrin Nr. 20, datë 24.02.2016, “Për dhënien e masë disiplinore ‘Vërejtje’”, ndaj nëpunësit *****.

Me Urdhrin Nr. 9, datë 13.03.2017, “Për anulimin e masës disiplinore”, ka anuluar Urdhrin Nr. 18, datë 24.02.2016, “Për dhënien e masë disiplinore ‘Vërejtje’”, ndaj nëpunësit *****.

Pas anulimit të akteve të sipërcituara, institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë ka fshirë masat disiplinore për këta nëpunës nga dosja e personelit dhe regjistri përkatës.

- Njësia përgjegjëse e institucionit në zbatim të pikës 8 të vendimit, për rregullimin e ligjshmërisë në procesin e ristrukturimit ka revokuar aktet si më poshtë:
 - Me Urdhrin Nr. 12, datë 17.03.2017, është revokuar akti nr. 32, datë 20.04.2016, “Për lirim nga shërbimi civil”, për punonjësin *****.
 - Me Urdhrin Nr. 13, datë 17.03.2017, është revokuar akti nr. 31, datë 20.04.2016, “Për lirim nga shërbimi civil”, për punonjësen *****.
 - Me Urdhrin Nr. 14, datë 17.03.2017, është revokuar akti nr. 30, datë 20.04.2016 “Për lirim nga shërbimi civil”, për punonjësen *****.
 - Me Urdhrin Nr. 15, datë 17.03.2017, është revokuar akti nr. 29, datë 20.04.2016, “Për lirim nga shërbimi civil”, për punonjësin *****.
 - Me Urdhrin Nr. 16, datë 17.03.2017, është revokuar akti nr. 28, datë 20.04.2016 “Për lirim nga shërbimi civil”, për punonjësin *****.

Në vazhdimësi të detyrave të lëna në këtë pikë, me shkresën nr. 396 prot., datë 21.03.2017, “Kërkesë për ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit të Institucionit të Prefektit të Qarkut Lezhë”, Prefekti i Qarkut Lezhë i ka kërkuar Departamentit të Administratës Publike, rishikimin e mundësisë së sistemimit të tyre në vendet e lira ekzistuese. Aktualisht pritet reagimi i njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.

Ndërkohë, punonjësi ***** ka ushtruar të drejtën e ankimit në gjykatë. Në këto kushte, referuar nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon se: *“Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga Gjykata”*, zbatimi i rekomandimit në lidhje me këtë rast nuk mund të ndiqet më tej nga ana e Komisionerit.

Për sa u parashtrua më sipër, pas përfundimit të afatit për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Nr. 155, datë 12.12.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*, të Komisionerit, rezulton se nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit janë zbatuar të gjitha rekomandimet e lëna në vendimin paralajmëruar.

Për këto arsye:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015, *“Kodi i procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* dhe Rregulloren, *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin Nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit, duke zbatuar plotësisht rekomandimet e Vendimit Nr. 155, datë 12.12.2016, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil në Institucionin e Prefektit të Qarkut Lezhë dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”*.
2. Verifikimin e mëtejshëm të pikave 2, 3 dhe 5 të dispozitivit të Vendimit Nr. 155, datë 12.12.2016, për të cilat kërkohet reagimi i Njësisë Përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
3. Për këtë vendim të njoftohet institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë, Departamenti i Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme dhe të informohet Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA